

AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT
(SKEMA E VLERËSIMIT)

Kjo është një skemë vlerësimi, në të cilën jepen **disa orientime** lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje.

Në vlerësimin e rubrikës *të shkruajmë* duhet pasur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të kërkesës, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarit.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që ju i gjykoni si të rënda.

Pyetja 11 (a) 1 pikë**Kujtimet e personazhit kryesor i ngacmon:**

- *dita e ngrohte e verës;*
- *dreka me familjen në kopsht;*
- *të ndodhurit në shtëpinë e prindërve.*

1 pikë Nëse tregon një nga arsyet (momentet) që ngacmon kujtimet e autorit.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 (b) 2 pikë**Dy shembuj:**

- *I përkëdhelte kokën.*
- *I thoshte fjalë të ngrohta.*

2 pikë Nëse identifikon dy shembuj.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një shembull.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 12 2 pikë**Cilësitë:**

- *I dashur me fëmijët (iu përkëdhel kokën);*
- *Rrëfimtari i mirë (iu tregon histori);*
- *I kujdesshëm (iu thotë fjalë të ngrohta).*

2 pikë Nëse identifikon dy cilësi që autori ka trashëguar nga i ati.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një cilësi.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

Pyetja 13 (a) 1 pikë

E veçanta e mënyrës së rrëfimit në vetën I, njëjës:

- *Përdorimi i kësaj vete e bën historinë më të ngrohtë, më personale.*

OSE

- *Përdorimi i kësaj vete bën që ngjarjet të shikohen më nga afër, të jenë më emocionale, më subjektive.*

1 pikë Nëse tregon të veçantën që fiton rrëfimi kur përdoret veta I, njëjës.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plotë.

Pyetja 13 (b) 2 pikë

Përgjigje e plotë: nxënësi duhet të theksojë lidhjen e fortë me babanë dhe sigurinë që i jep prania e tij.

- Kjo ndjesi e autorit për të atin tregon **lidhjen e fortë** me babanë dhe besimin që ka tek ai. Babai, ai njeri i shëndoshë, me nofulla të forta e sy shkrepëtitës, shihet si mbrojtës dhe **siguri** për jetën e familjen. Ndaj mendimi se mos largohet një ditë, ngjallte frikë tek djali i vogël dhe i brishtë.

Përgjigje e pjesshme:

- Autori tregon lidhjen e fortë me të atin.

OSE

- Djalit i jep siguri prania e babait.

2 pikë Nëse interpreton në mënyrë të plotë ndjesinë e fëmijës.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në mënyrë të pjesshme ndjesinë e fëmijës.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plotë.

Pyetja 13 (c) 2 pikë

- Autori, me anë të metaforës së përdorur, na tregon se po depërton në të kaluarën e tij të largët, fëmijërinë, me anë të kujtimeve dhe të imagjinatës së tij.

OSE

- Titulli shpreh në mënyrë të figurshme (përmes metaforës), udhëtimin pas në kohë të autorit, në vitet e hershme të fëmijërisë, gjurmët që lanë këto vite në jetën e tij.

2 pikë Nëse zërthen në mënyrë të plotë domethënien e titullit, duke iu referuar edhe figurës së metaforës.

OSE

1 pikë Nëse zërthen domethënien e titullit pa e nënvizuar figurën e metaforës ose gjen Metaforën, por nuk e zërthen domethënien e titullit.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

Pyetja 14 3 pikë

- **Përgjigje e plotë:** nxënësi duhet të nënvizojë se si transmetohet **dashuria dhe kujdesi** që autori ka marrë nga i ati. Autori ka krijuar të njëjtin **raport** me fëmijët e tij, ashtu si dikur i ati i tij me të.

OSE

- Raporti shumë i mirë që ka pasur me të atin është transmetuar edhe te kujdesi që ai ka për fëmijët e tij. Ai i përkëdhel ata njësoj si i ati, iu vë emra përkëdhelës, iu tregon histori; tregon të njëjtën vëmendje dhe shqetësim për fëmijët e tij, ashtu si dikur i ati vepronte me të.

- **Përgjigje e pjesshme:** nxënësi konstaton pa shpjeguar ndikimin që fëmijëria ka lënë te autori.

- Mënyra se si i ati është sjellë me të, është transmetuar edhe te marrëdhënia e tij me të bijën.

OSE

- Autori është rritur me shumë kujdes dhe dashuri nga i ati.

➤ **Ilustrime**

- *Veprimet e tij i shoh e i ribëj edhe unë.*
- *Kur jam duke prekur një nga fëmijët e mi, shoh duart e tim eti mbi të miat.*
- *Edhe unë sajoj emra përkëdhelës për kolopuçët e mi, sikurse sajonte ai për mua.*
- *Në vesh kam shprehjet që ai përdorte, sharjet që nuk i kursente e që tani janë pa pikë kuptimi, por që atë e bënë të gajasej aq shumë.*
- *Edhe historitë që unë tregoj, i kam prej tij.*

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë se si ka ndikuar fëmijëria te autori.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme se si ka ndikuar fëmijëria te autori.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e ilustron me shembuj nga pjesa.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim:

Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk për afrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.

Pyetja 15 **2 pikë**

1 pikë prapashtesa: **im**

1 pikë mbaresa: **-et**

Pyetja 16

1 pikë qelqi – gjinia mashkullore,

1 pikë rasa rrjedhore pa parafjalë

Pyetja 17

1 pikë **B**

Pyetja 18

1 pikë Babai im ishte po aq i shëndoshë sa edhe xhaxhai. (shembull ilustrues)

Pyetja 19 (a)

1 pikë i- trajtë e shkurtër, rasa kallëzore,

1 pikë veta e tretë

Pyetja 19 (b)

1 pikë Dhoma e prindërve të mi qenkësh bashkuar me timen përmes një porte të dyfishtë.

Pyetja 20 (a)

1 pikë kryefjala: im atë

1 pikë shprehur me GE (emër dhe përemër pronor)

Pyetja 20 (b)

1 pikë gjithçka: kundrinor i drejtë, *shprehur me përemër të pacaktuar*

Pyetja 21 (a)

1 pikë hap nga frika

1 pikë hap ngadalë (hap me shpejtësi)

Pyetja 21 (b)

1 pikë kallëzuesi emëror: ishte mjek

1 pikë përbërë nga: folja këpujë *jam* dhe emri *mjek*

Pyetja 22 **D** **1 pikë**

Pyetja 23 **C** **1 pikë**

Pyetja 24 **A** **1 pikë**

Pyetja 25

6 pikë

Për pjesën *të shkruajmë* do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- *përshkruan* një periudhë;
- *tregon arsye* pse hoqi dorë nga diçka;
- *shpjegon* çfarë ndodhi dhe ndjesitë që provoi.
- Përzgjedh detaje dhe shprehje për të dhënë specifika të ngjarjes dhe të ndjesive, duke krijuar kështu përfytyrime tek lexuesi;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: STRUKTURA

1 pikë

- respekton elementet:
 - hyrjen (e dhënë);
 - zhvillimin;
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

1 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta;
- ka saktësi drejtshkrimore.